

VENDIM
Nr. 187, datë 23.11.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONÇESIONARE” SHPK, PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, 21 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, neni 4, pika 1, germa “g”; neni 5, pika 2; neni 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” e rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Nga aplikimi i shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., rezulton mungesa e dokumentacionit si më poshtë:

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.);

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar); germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti) dhe germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur);

- Në korrespondencë zyrtare me ERE-n, shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., i është bërë kërkesë e përsëritur për plotësimin e dokumentacionit të munguar;

- Shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje e as ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e tregtimit të kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti